



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____.____.2023

Lënda: PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot më datë 28.02.2023, në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr.45 me nr.380 prot., datë 27.02.2023, të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

Objekti Prokurimit: “Supervizion për rikonstruksionin e shtëpizave të mbështetura”
për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP) : 79421100-2 Shërbime të supervizimit të projekteve, përjashtuar projekte e ndërtimit.

Vlera e fondit limit: 2,218,272.07 (Dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë 07) **Lekë pa TVSH.**

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë nga grupi i ngritur për argumentimin e fondit limit, grupi i është referuar VKM nr.354, datë 11.05.2016 ”Për Tarifat e studimit, projektimit, Drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”, seksionit I, grupit IV tarifor, faza VIII dhe faza IX.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Spitali Psikiatrik ”Ali Mihali” Vlore, (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

- **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë :

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, në shumën 44,365.44 (Dyzet e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë 44).

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë :

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 8).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet, konkretisht jo më e vogël se 2,218,272.07 (Dy milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë 07) Lekë pa TVSH.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda dates 31 mars të vitit pasardhës.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019 , 2020 dhe 2021, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore : Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kjo kërkesë është bërë në përputhje me pëcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale :

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit që prokurohet konkretisht, në vlerën **887,309** (Tetëqind e tetëdhjet e shtatë mijë e treqind e nëntë) leke pa tvsh, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur.

- a) Kur kontrata është realizuar me institucione shtetërore, ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nënshkruar, vërtetim për realizimin me sukses** nga institucioni me të cilin është lidhur kontrata të shoqëruar me **faturen tatimore**.
- b) Kur kontratat janë të realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqesë **kontraten e nënshkruar dhe faturat tatimore** ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentim: Vendosja e kriterëve të mesipërme është e domosdoshme po të kemi parasysh se kemi të bëjmë me një investim të rëndësishëm për të cilin operatori/et ekonomike duhet të kenë kapacitetet e nevojshme dhe ajo çka është me kryesore të kenë eksperiencën e duhur dhe përvojë në realizimin e punëve të ngjashme në natyrë dhe në vlerën e tyre. Vendosja e kriterit të sipërcituar, është në mbështetje të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, nëni 46 pika 1 dhe VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nëni 26 pika 5 dhe 6, ku përcaktohet se: “Kërkesat e vecanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nënin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të shërbimeve (mbikqyrje punimesh zbatimi) të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.** Plotësimi i kushtit të mesipërme e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të leshuara nga një ent publik ku të shihen vlerat, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo dokument tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vetëm faturat tatimore, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërisë, lidhur me shërbimin e mbikqyrjes.

Bazuar në V.K.M nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, liçenca e shoqërisë duhet të jetë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P - 2** Ndertime civile dhe industriale.
- **N.P - 7 a,b,c** Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 1** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 2** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S - 12** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- **N.S - 14** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të paraqesin njehsimin e licencave profesionale që disponojnë (të lëshuara nga vendi i origjinës), pranë Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastrukturës në plotësimin e Licencave Profesionale të kërkuara për ekzekutimin e Kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në V.K.M nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Licencat e mesiperme janë të njëjta me licencat e objektit të prokurimit “**Rikonstruksion i shtëpizave të mbështetura**”

REF-58877-02-13-2023

AK-ja në përcaktimin e kategorive të licencës së kërkuar në këtë procedurë prokurimi merr në konsideratë Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pasi në përzgjedhjen e kategorive dhe klasave të licencës, licencat e mbikëqyrësit janë të njëjta me ato të ndërtuesit.

2.3.3 **Deshmi për stafin punonjës të operatorit ekonomik**, ku numri mesatar i punonjësve të siguruar të jete jo më i vogël se **12 (dymbëdhjete)** punonjës për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023** Për këtë duhet të paraqesë:

- **Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore**, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023**.

- **Listepagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore**, Shendetesore dhe Tatimit mbi të ardhurat nga Punesimi, për periudhën **Nentor 2022 – Janar 2023**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

➤ **1 (nje) inxhinier Ndertimi**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te punimeve te ndertimit ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, duke u bazuar ne legjislacionin e prokurimit public ku percaktohet se cdo kriter duhet te jete ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates.)

➤ **1 (nje) inxhinier Hidroteknik**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te punimeve furnizimit me uje dhe rrjetit te kanalizimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, duke u bazuar ne legjislacionin e prokurimit public ku percaktohet se cdo kriter duhet te jete ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates.)

➤ **1 (nje) inxhinier Mekanik**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te sistemeve mekanike ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, duke u bazuar ne legjislacionin e prokurimit public ku percaktohet se cdo kriter duhet te jete ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates.)

➤ **1 (nje) Arkitekt**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te punimeve te ndertimit ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, eshte ne mbeshtetje te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 46, ku percaktohet se: Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Inxhinieri i mjedisit eshte pergjegjes per ,mbikeqyrjen e punimeve te zbatimit te lidhura me ndikimet ne mjedis, habitatet e ndikuara nga ky objekt, shkarkimet dhe depozitimet e mbetjeve.

➤ **1 (nje) inxhinier Elektrik**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te punimeve elektrike ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, duke u bazuar ne legjislacionin e prokurimit public ku percaktohet se cdo kriter duhet te jete ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates.)

➤ **1 (nje) inxhinier Gjeodet**

(Kriteri i mesiperm eshte vendosur mbi bazen e kontrates se zbatimit, te punimeve te ndertimit ne preventiv dhe specifikimeve teknike ne projekt, eshte ne mbeshtetje te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006” Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 46, ku percaktohet se: Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Inxhinieri gjeodet eshte pergjegjes per mbikeqyrjen e punimeve topografike ne objekt duke filluar qe nga rilevimi fillestar, piketimet e struktures se objektit si dhe deri ne sistemimet e jashtme dhe rilevimet perfundimtare.

Inxhinierët e mësipërm duhet të jenë në licensën e kompanisë dhe të figurojnë në listë pagesat e punonjësve të shoqërisë.(Formularët E-Sig 025/a.1).

Per kete OE te paraqese:

- Licensat personale te vlefshme sipas VKM nr. 943, datë 28.12.2016
- CV-të
- Kontrata e punes.
- Diplome
- Licence Profesionale

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas **shtojcës 9 te DST.**

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë pjese të stafit ekspert privat zjarrfikes te Certifikuar per Hartimin e Projekteve te Mbrojtjes nga Zjarri.

Per kete OE te paraqese:

- Diplomen
- Certifikaten per ushtrimin e profesionit

Kontrata e punes dhe te figuroje ne Formularët E-Sig 025/a.1 per periudhen **Nëntor 2022 – Janar 2023**, e kerkuar me siper.

Argumentimi: *Vendosja e kriterit te ekperiences se inxhinierëve, eshte bere ne mbeshtetje te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimet Publike” te ndryshuar, neni 46, pika 1 dhe VKM nr.914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 26, pikat 5 dhe 6, ku percaktohet se kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me afesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktojë dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatorët ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve.*

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës e) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ekuivalente) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (ekuivalent) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2011 (ekuivalent) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, në rastin kur janë në gjuhë të huaj duhet të përkthehen në gjuhën shqipe, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manulit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ZYRTARI I AUTORIZUAR

Loreta Balaj